



Pranuar / Dorezuar / Prijmëno / Protuto / Received / Delivered	22.06.2023	3	viti / god / year
Organ / Njësia / Org. / Jedinica / Org. / Unit	SKIMSICK	4876 / 2023	114



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.615/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.2086/2021 të datës 25.05.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.615/2021 të datës 06.07.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi: fshati Komuna e Fushë Kosovës, kundër organit të punësimit/Komunës së Fushë Kosovës, në çështjen juridike "*kërkesë nga marrëdhënia e punës*" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 22.06.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa A.nr.615/2021 e datës 06.07.2021 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi, sipas shkresave të lëndës i punësuar në Komunën e Fushë Kosovës me datë me datë 06.07.2021 kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar me Nr. prot: 3475/2021, kundër përgjigjes së datës 23.02.2021 të Udhëheqëses të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Fushë Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 12.07.2021, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Komuna e Fushë Kosovës. Ndërsa Këshilli me datë 22.07.2021

ka pranua nga Komuna e Fushë Kosovës përgjigjen në kërkesë me numër protokolli: 3848/2021, se bashku me shkresat e bashkangjitura.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në kohën e parashtrimit të ankesës nga ankuesi ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 19.08.2021, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi, ka ndjekur procedurat e tjera administrative duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 25.05.2023 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.2086/2021 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e datës 19.08.2021 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e ankueses të datës 06.07.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.prot:3475/2021 të datës 06.07.2021 e parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen e datës 23.02.2021 me numër prot:209; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; Akt emërimit të datës 01.07.2016; Ankesa e datës 22.01.2020; Listën e pagave për periudhën kohore 01.11.2018 deri 30.11.2018; Listën e pagave për periudhën kohore 01.01.2019 deri 31.12.2019; Listën e katalogut të vendeve të punës në Shërbimin Civil; Kërkesën për pushim të datës 13.07.2018; Kërkesën për pushim të datës 24.06.2019; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën "Zyrtar për zhvillim rural dhe statistike"; Ftesën për seancë dëgjimore të datës 30.01.2020; Ankesën e datës 13.01.2020; kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 12.07.2021; Përgjigjen në kërkesë të datës 22.07.2021; Akt emërimit të ankuesit të datës 01.06.2011; Kërkesën e datës 06.12.2019; Përgjigjen në kërkesë të datës 13.01.2020; Ankesën e datës 22.01.2020; Formularin për parashtrimin e kërkesës së datës 22.01.2020; Ankesën e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave kundër përgjigjes së datës 13.01.2020; Vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të datës 11.02.2020 me numër prot:194; Vendimin e datës 07.07.2015; Parashtrësën e datës 18.08.2020 me numër protokolli:698; Përgjigjen e datës 25.08.2020 me numër protokolli:1341; Kërkesën e datës 03.11.2020 me numër prot:1069; Përgjigjen e datës 23.11.2020 me numër protokolli:1708; Kërkesën e datës 11.01.2021 me numër prot:10; Aktgjykimin A.nr.2086/2021 të datës 25.05.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa A.nr.615/2021 e datës 06.07.2021, e parashtruar nga ankuesi është e **palejuar**, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se ankuesi sipas akt emërimit të datës 01.07.2016 është i punësuar në Komunën e Fushë Kosovës në pozitën "Udhëheqës i Sektorit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural", ndërsa me datë 11.01.2021 ka parashtruar kërkesë për ngritje të koeficientit pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore, kurse Udhëheqësja e Njesisë së Burimeve Njerëzore me datë 23.02.2021 i ka kthyer përgjigjen me numër protokolli:209 duke e njoftuar palën se kërkesa e tij nuk mund të realizohet pasi që i njëjti i ka



humbur afatet sipas Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sikurse ia rikujton faktin se ankuesi të njëjtën kërkesë e ka përsëritur disa here.

Po ashtu, Kolegji për shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka gjetur se në bazë të provave të lëndës të ofruara nga Komuna e Fushë Kosovës, ankuesi për të njëjtën kërkesë-ngritje të koeficientit kishte parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, ku i njëjti komision me datës 11.02.2020 kishte nxjerr vendimin me numër prot:194 duke e refuzuar ankesën e ankuesit, më këshillin juridike, citoj: *"Pala e pakënaqur ka të drejtë ankese pranë këshillit të pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, në afatin prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi"*, mirëpo këtë të drejtë pala ankuese nuk e kishte shfrytëzuar brenda afateve kohore, mirëpo ankuesi pavarësisht këshillës së dhënë nuk i ka ushtruar mjetet e dhëna juridike brenda afateve të përcaktuara ligjore.

Duke marrë për bazë dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 125 paragrafi 1, 3 dhe 4 i cili përcakton se: *"Përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrohet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative (në vijim: "heshtja administrative")"* si dhe neni 127 paragrafi 1 i cili përcakton se: *"1.Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ; 3. Nëse akti administrativ është lëshuar pa informacion, apo me informacion të pamjaftueshëm në lidhje me mjetet juridike administrative (këshillën juridike), afati i parashikuar nga paragrafi 1 i këtij neni, është tre (3) muaj. 4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ"*, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshill me datë 06.07.2021 kundër përgjigjes së datës 23.02.2021 të Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore është e jashtëafatshme, pasi që ankuesit ka filluar t'i rrjedh afati për parashtrimin e ankesës nga momenti i pranimit të përgjigjes së Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore, gjegjësisht ankuesi nuk e kundërshton datën e pranimit të përgjigjes së datës 23.02.2021.

Prandaj, Kolegji i Këshillit nga të gjeturat e dhëna si më lartë, konstaton se ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 06.07.2021 është parashtruar në kundërshtim me nenin 127 paragrafi 1, 3 dhe 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, andaj është hedhur poshtë si e palejuar sikurse në dispozitiv të këtij vendimi pasi që nuk e plotëson kushtin e nevojshëm të pranueshmërisë së ankesës në kuptim të neni 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *"Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.3. ajo është parashtruar brenda afatit të parashikuar nga neni 127 i këtij ligji."* dhe si e tillë ankesa e ankuesit e datës 06.07.2021 është hedhur poshtë si e palejuar sikurse në dispozitivin e këtij vendimi, për shkak se është parashtruar jashtë afateve të përcaktuara kohore.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.*



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.615/2021

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- *Ankuesit*
- *Kryetarit të Komunës së Fushë Kosovës;*
- *Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën se Fushë Kosovës dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së*

